

KOZMETIKA

Ballina: Arbësa Rexhepi



**KU TA GJEJ
NJË PENSIONIST
QË JETON MIRË**




**GJILANASI
QË MORI PJESE
NË 30 LUFTËRA**

**POLITIKANËT TANË
FLASIN NDRYSHE,
VEPROJNË NDRYSHE**

**MË ZURI TAKSIRATI
ME GRA TË PRISHTINËS**

**DASHNORI I PARË
U KALLTË N'XHEHENEM**

**“BEAUTY ZONE BESA”
I ARBESA REXHEPIT,
SALLONI MË PROFESIONAL
DHE MË I VEÇANTË NË ZVICËR**





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend

ANTALYA | TURKIYE



SHERWOOD
SHERWOOD
SHERWOOD



SHERWOOD
SHERWOOD
SHERWOOD



SHERWOOD
SHERWOOD
SHERWOOD



BUĞ
BUĞ
BUĞ



SHERWOOD
SHERWOOD
SHERWOOD



GREENWOOD
GREENWOOD
GREENWOOD



GREENWOOD
GREENWOOD
GREENWOOD

www.sherwoodhotels.com.tr | www.greenwoodhotels.com.tr

+90 444 88 07

“Beauty Zone Besa” është zona e bukurisë që tashmë ka vulën e suksesit në Zvicër, shkak i profesionalizimit të lartë në kryerjen e shërbimeve. Hapur në fund të vitit të kaluar, salloni i Arbesa Rexhepit ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe një atmosferë të mrekullueshme e mikpritëse për klientët. Tek “Beauty Zone Besa”, në Cyrih të Zvicrës, ofrohet pastrimi dhe zbardhja e dhëmbëve, hairextensions, ngjyrosja dhe prerja e flokëve dhe make-up profesional. Pra, të gjitha në një vend... Për sallonin, suksesin dhe vetë atë, flet ekskluzivisht në “Kosovare”, Arbesa Rexhepi...



“Beauty Zone Besa” i Arbesa Rexhepit, salloni më profesional dhe më ekskluziv në Zvicër



Si e përshkruan veten Arbesa Rexhepi?

- Jam vajzë, 30-vjeçare, e lindur e rritur në Zvicër. Për sfondin profesional mund të them se të gjitha i kam kryer me shumë sukses në Zvicër. Pas zanatit 3-vjeçar, si e ndihmëse e stomatologut, kam kryer shkollën e lartë për higjieniste dentare, sepse më ka pëlqyer gjithmonë mirëmbajtja dhe estetika e dhëmbëve.

Më duhet të them se prindërit që në fëmijëri më kanë mësuar të jem mirënjohëse dhe e respektueshme. E kam një sindromë: ndihem e detyruar t'u ndihmoj atyre që kanë nevojë, me aq sa kam mundësi. Jam një vajzë me qëllime dhe ëndrra të mëdha, e pavarur dhe që kam punuar shumë për t'ia dalë në jetë. Jam shumë kokëfortë dhe e bëj të pamundurën për të arritur cakun.

Jam e sigurt në vete dhe e bindur për suksesin tim...

E, të tjerët si të përshkruajnë?

- Si një vajzë impulsive dhe me karakter të veçantë. Person që nuk dorëzohet lehtë, me shumë kapacitet, e suksesshme, gjithmonë me shumë ide, interesim në maksimum për diçka të re, pozitive, person me zemër të madhe dhe që i ndihmon





të gjithë, edhe nëse e lë veten keq.

A je sot ajo që ke dashur të jesh?

- Synimi im është shumë më i lartë se sa ku jam sot. Ky është, thjesht, fillimi... Për të tjerat jam shumë krenare me vetveten që kam arritur këtu ku jam sot.

Dhe, të gjitha kushtet që ia kam vënë vetes i kam mbajtur.

Kam pasur sakrificë dhe anashkalime që është dashur t'i përballoj, por ia kanë vlejtur.

Si u bërë pjesë e botës së bukurisë, estetikës?

- Ëndrra ime ishte që të jem në këmbët e mia, në profesionin tim. Fusha e bukurisë nuk ishte bash pjesa që e mendoja. Por, kur më lindi ideja ta realizoja profesionin tim si Dental Hygienic, në një sallon timin, desha të bëj diçka më interesante e më shumë shërbime, ku bukuria mund të arrihet deri në maksimumin e saj.

Pak fjalë për sallonin tuaj të preferuar "Beauty Zone Besa"?

- Salloni im është shumë luksoz dhe ekstravagant. Një ambient relaksues

dhe mikpritës për të gjithë.

U kam kushtuar vëmendje detajeve të vogla, andaj salloni dallon nga të tjerët në rrethin tim.

Kam një staf tejet pozitiv dhe klientelë të kënaqur, pasi punojmë ndershëm.

Për çka vijnë më shumë klientët në sallonin tuaj dhe cili është shërbimi më i kërkuar?

- Vijnë për të gjitha shërbimet, e posaçërisht për pastrimin e dhëmbëve dhe hairextensions, sepse kualiteti i produkteve, flas për materialin e zbardhimit të dhëmbëve dhe flokëve për hairextensions, është më i larti dhe më i adhurueshmi nga klientët.

A ka edhe fytyra publike që vijnë te ju?

- Po, kemi edhe fytyra publike, sepse rrethi im është shumë i madh. Kam raporte të mira me të gjithë, e, po ashtu, edhe me fytyrat publike.

Për hapjen e sallonit kam pasur nderin ta kem mysafire Melinda Ademin, ndërkohë që i është bërë edhe stylingu nga stafi im profesional.

Arbesë, diç jashtë profesionit?

- Jam gjithmonë "on the way". Kam qejf ta shëtisë botën dhe non-stop të jem aktive si për qejfet e mia, e edhe për ide të reja për "Beauty Zone Besa".

Dikujt që i thua faleminderit?

- Falënderimi i takon familjes dhe rrethit që më kanë mbështetur emocionalisht dhe nuk më kanë lënë të dorëzohem...

Gjëja pa të cilën nuk mundesh?

- Pa familjen dhe pa rehatinë time, si dhe njerëzit që i kam për zemër. Të tjerat bëhen ose blihen...

Mesazhi yt?

- Realizoni ëndrrat tuaja! Pa e provuar nuk mund ta dini se sa përpara mund të ecni!

Mirëpo, edhe dështimi, nëse ndodh, nuk është fundi i botës, meqë kur një derë mbyllet – hapet një tjetër, thotë populli.

Faleminderit për bisedë!

- Faleminderit juve!

Nderim Neziri

Ku ta gjej një pensionist që jeton mirë?

Vështirë është ta presësh muajin me 100 euro pension, sepse ka pensionist që 50 euro në muaj i shkojnë vetëm për barëra!

E, ku është rryma, e cila për ditë flitet se ende do të shtrenjtohet, ku është pagesa e tatimit në pronë, pagesa e bërllokut, e ujit, e shpenzime të tjera që s'kanë fund?!

"Shyqyr që jemi në Ramazan dhe nuk po hamë sa na duhet. Tash po mendojmë vetëm për iftar dhe për syfyr dhe një racion e kemi më pak. Kjo po na e kalon pak më lehtë gjendjen, edhe ashtu të rëndë ekonomike", thotë Istref Jetullahu, pensionist nga "Kodra e Trimave" në Prishtinë, i cili tërë jetën e tij, prej se e mbanë mend, ka punuar argat te "Tregu i devizave", e që tash, kur ka shkelur në të 70-at, më nuk del, sepse jo vetëm që e ka lëshuar fuqia, por nuk e merr kush për punë kur e sheh asht e lëkurë! Dhe, vazhdon: "Jam martuar vonë, sepse s'kishim gjë mas shpirtit! Ku me marrë pare me u martua. Pas lufte një kushëri imi më tha se

gruaja e tij e kishte një teze që ishte ndarë nga burri dhe është e interesuar të martohej përsëri.

I thashë: E marrë menjëherë!

Dhe, pa e zgjatur shumë u martova dhe nisa të krijoj familje në pleqëri, sepse në atë kohë isha rrafsh 55 vjeç. Më lindën dy vajza rresht dhe djali, i fundit.

Vajzat janë martuar e djali ende jo, sepse është i ri dhe po mundohet me punua ku po gjen punë dhe po ma jep pak krahun se nuk di s'i do i dilnim në krye jetës së vështirë skamnore nëpër të cilën po kalojmë!."

NË SHESH SHEH VEÇ LYPSARË!

"Shpesh dal në sheshin e Prishtinës për të takuar ndonjë të njohur, për të kaluar një pjesë të ditës, sepse qe 10 vjet jam në pension dhe s'po kam si me e kaluar kohën", thotë Fikri Kushumlia, nga Lagjja "Mahalla e Muhaxherëve", në Prishtinë.

Dhe, shton:

"Kam nevojë të eci nga pak se jam i sëmurë nga frymëmarrja dhe nuk preferohet të qëndroj vetëm në shtrat. E, në shesh, çka me pa?

Fëmijë, gra, pleq e të rinj lypsarë ta shtrinë dorën për lëmoshë!

Dhe, ndaj kujt se?!

Ndaj neve, pensionistëve, të cilët bëjmë jetë me 100 euro në muaj, sepse tërë jetën kam punuar, por jo

në punë të shtetit, sepse kudo që paraqitesha për punë më thoshin nuk kemi nevojë!

Andaj, tepër mirë jam çfarë punësh të rënda kam bërë: Sa betonin e kam përzier me lopatë; sa thesin me cement e kam bartur në shpinë; sa bunarin e kam hapur me kazmë e lopatë, e çka jo tjetër!

Por, njeriu qenka më i fortë se guri! Pse?

Se gurit po i mëshove me çekan qahet.

E, njeriu është ai që me çekan i mëshon gurit dhe vetë mbetet gjallë! Por, çka të bësh?!

Kështu e paska jeta!

Tash po flitet se edhe rryma do të shtrenjtohet, se qenka e lirë, sipas pushtetarëve!

E, po u shtrenjtua rryma më mirë me na e marrë Zoti shpirtin se të jetojmë kështu, në skamje, siç po jetojmë tash!."

SI TA PËRMBYLLË KËTË SHKRIM?

Si dy bashkëbiseduesit e mi pensionistë ka edhe të tjerë, sa të duash në Kosovë, që bëjnë jetë në luftë me skamjen.

Por, ku ta gjej një pensionist në Kosovë që jeton mirë, bën jetë të mirë?!

Isa ILAZI



KOSOVA – LIVADH I MADH!



Thoshte jo rrallë im gjysh, e që po më kujtohen edhe sot fjalët e tij: "Kosova është livadh i madh, babo! E hanë edhe kuajt qorr!".

Ai, im gjysh, Zeneli, kishte pas qenë asker i Perandorisë Osmane. Luftërat e kishin qitur të jetojë në Stamboll, hiç më pak se 13 vjet!

Histori e gjatë e tij. Por, më kujtohet një detaj, që e tregonte shpeshherë, sa herë që flitej për Kosovën...

Tregonte se si baba-mbret i Turakisë, sa herë qohej, me sabah, shkonte te kali-at i tij dhe lutej: "Ma bafsh baglën në Kosovë!".

Demek, edhe sipas mbretit, Kosova është një pasuri që ka ditur me e falë veç Zoti në këtë dynja...

Andaj, edhe perandoritë, krajlitë e

mbretëritë turli-turli e lakmonin ta pushtonin, ta fitonin, ta kenë të veten... Tregim ky që për momentin aktual flet shumë...

Flet dhe tregon shumë pse-he për problemin që s'largohet nga Kosova tash e shekuj me radhë...

Andaj, po i përsëris fjalët e tim gjyshi: "Kosova - livadh i madh!".

E, se është livadh i madh dhe që e lakmojnë edhe të tjerët, flet më së miri shtrirja e ushtrisë serbe rreth kufirit me Kosovën.

Por, shyqyr Zotit, Aleanca më e fortë botërore, NATO, është në Kosovë dhe, siç tha ditë më parë ambasadori amerikan në Kosovë, kosovarët mund të bëjnë gjumë të rehatshëm...

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Ardita Dili
Edona Vllasaliu - Bajoku
Xheneta Spahiu
Denisa Oruqi

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com



Pse askush nuk u mor në përgjegjësi për vrasjen e 8 anëtarëve të familjes Sharku në Rahovec?

Ishte viti 2004, kur unë u gjenda në Rahovec, tek ndodhesha në qytezën e shumë legjendave dhe të shumë vrasjeve...

Më datën 9 maj 1999 Rahovecin e kishte kapluar një ngjarje makabër: Ishin vrarë në shtëpinë e tyre tetë anëtarë të familjes Sharku: Bashkëshortët Ali dhe Taibe Sharku, vajza e tyre Azeminja, me fëmijët - Visarin, Arzën, Venharin, Egzonën dhe Shkurtën tetë vjeçe. Vrasja ishte kryer në shtëpi nga policët serbë me armë pa zë. Të gjithë anëtarët ishin qëlluar me plumba.

SI E TREGOI VRASJEN MAKABËR TË FAMILJES SHARKU, VAJZA FETIJA?
Përshkrimi vajzës së Aliut dhe Taibes, Fetijes, ishte tronditës. Ajo në hollësi ka treguar se si e gjeti shtëpinë e mbushur kufoma...

"Ka qenë ditë e diel. Data 9 maj 1999. Flitej se Rahovecin donin ta dëbonin për në Shqipëri.

Nuk kaloi as një orë dhe grupi i parë i fqinjëve, që ishte kthyer nga stacioni i autobusëve, pasi erdhën në shtëpi, thanë: "Policia serbe nuk po lejojnë askënd të shkojë në Shqipëri!"

Serbët e Rahovecit, të veshur me uniforma policore dhe të mobilizuar për luftë, u thanë banorëve: "Kur bien bombat e NATO-s mbi kokat tona,

le të bien edhe mbi kokat tuaja!"

Po atë ditë, mora djalin e vogël dhe u nisa t'i vizitoj prindërit.

Ka qenë ora 11, kur u nisa me Benjaminin e vogël që të shkoja te prindërit. Dhe, duke ditur se aty ishte edhe motra, Azeminja me fëmijë, u ndala në shitore dhe bleva çokolata për fëmijët.

Kur arrita në lagje, në derë të oborrit u ndala. Dera e oborrit ishte e hapur. Thashë me vete: Pse është e hapur dera, në këtë kohë kaq të keqe?!"

Hyra ngadalë në oborr. Ishte qetësi...

U ofrova te dera e korridorit, e cila, gjithashtu, ishte e hapur.

Pastaj, u ofrova edhe te dera

e dhomës, e që edhe ajo ishte e hapur! Kur e futa kokën në derë të dhomës, të parin e pashë Visarin, 13 vjeç. E kishte gjysmën e trupit në dyshek e gjysmën në shtrat. U ofrova dhe e preka. Ishte i ftohët, akull. E kishte plagën në ballë, e plagën tjetër në anën e djathtë të kokës, ndërsa një plumb e kishte qëlluar mu në zemër! Kur u binda se ai ishte i vrarë, më shkoi në mend se të gjithë të tjerët qenkan vrarë... E pashë, pastaj, Egzonën, tetë vjeçe, të shtrirë në dysheme! Ashtu, siç ishte munduar të ikte, kishte mbetur e shtrirë... Edhe ajo i kishte tre plumba: dy në kokë e një në zemër! U humba e tëra dhe fillova të qaj. Nuk dija çka të bëja! U ndala për një moment dhe pyeta veten, mos kisha luajtur, por pamjet e krimit më demantuan menjëherë... Në ato çaste shkova te shtëpia e hallës Çelebije. Doli ajo në derë me burrin, Sylejmanin.

I thashë: "Eja e shihni çka kanë bërë shki- jet?!". Hymë me hallën në shtëpi. I preku të gjithë fëmijët e vdekur... Dola në rrugë dhe fillova të qaj...", thotë në rrëfimin e saj tron- ditës Fetija.

**PËR DINARIN
ÇOHET PLUHUR,
PËR VRASJET
NDAJ SHQIP-
TARËVE HESHTET!**
Në familjen Sharku në Rahovec kanë marrë shënime shumë zyrtarë të lartë rreth vrasjes së një familje- je në shtëpinë e tyre, por askush nuk është marrë në përgjegjësi! E, për dinarin serb në Kosovë Serbia e ka alarmuar tërë bashkësinë ndërkomb- bëtare!
Shiheni presionin ndërkombëtar?!
Shiheni diplomacinë ndërkombëtare për dinarin?!
E, për vrasjet e familjes Sharku në Rahovec dhe për mijëra vrasje të tjera në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare bëhet kinse nuk di gjë!
Tmerr, a?!

Sokol Murturi



Sadik Krasniqi

Këndi i poezisë

Sadik Krasniqi u lind më 1961, në Llukar të Prishtinës.

Diplomoi në Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Universitetin e Prishtinës.

Është anëtar i Asociacioneve relevante letrare kulturore shqiptare në Gjermani e mërgatë.

Ka botuar librat: "Ofshamë në urnë", "Lacrima vietii" ("Loti i jetës"), "Oazë palmash të djegura", "Ag muzgu", "Lutje në mëngjesin e zymtë", "Parajsë e nëmur".

Poezitë e Sadik Krasniqit janë përfshirë në disa antologji, si dhe janë përkthyer në rumanisht.

Është laureat i disa çmimeve letrare.

Krahas poezisë shkruan tregime, vështrime kritike, si dhe shkrime publicistike.

Jeton në Gjermani.

Nga libri "Ag muzgu" shkëpusim dy poezi...

TË GJALLËT E TË VDEKURIT

Të gjallët
hanë bukën e tokës

tokën e bukës
hanë të vdekurit

kafshatë kafshatë
të gjallët

të vdekurit
pash më pash

me nga një gur në kokë
kanë ardhur deri te lumi.

BLLACA

Balta e vdekur
na ha për së gjalli
në këtë ferr

në këtë tokë të nëmur
jam çelur
lule robi

i pikëlluari im
merrmë si flutur në dorë
gëzoje pranverën.

Pash ëndërr se Qeveria falte tokë!



Atë natë frynte erë e fuqishme, që rrapëllonte llamarinat e mureve të fqinjëve dhe telat e rrymës përplaseshin me njëri-tjetrin, duke hedhur në tokë xixa. Ndërkaq, njerëzit luteshin të binte shi, sepse do e ndalte erën, por retë dhe qielli nuk premtonin diçka të tillë...

E mbuloja kokën me jorgan, që të mos i dëgjoja sado pak rrapëllimat e llamarinave, por as ajo nuk ndihmonte. Më në fund, më kishte kapur kllapia e një gjumi që më shumë shfaqte ëndrra të trishta, sesa gjumë pushimi. Po ecja një lugine në trojet e dikurshme shqiptare në Toplicë dhe përnjëherë para meje u shfaq një oborr me lule, të cilat i ujiste oborrtari. Oborrtari, me maramë, plis e mjekër të bardhë, si dhe me pelerinë, dukej si një kaftan i kohëve mbretërore, që i jepej një personaliteti kur ai merrte pozitë në mbretërinë e vendit. Shihja shumë kuaj të lidhur për një ram druri dhe pak më tej shumë ushtarë kohësh perandorake, tek të cilët vezullonte shkëlqimi i shpatave dhe kamave të brezit. Dy prej tyre më dolën para dhe, pa më folur gjë, nisën t'i shikojnë gjithë kureshtje

rrobat e mia.

Ata nuk dinin se nga cila kohë vija unë... Dy botë njerëzish ballafaqoheshim në një oborr, që më ngjasonte në selinë e Perandorisë Osmane në Stamboll: Ata, me rroba, jelekë, parzma e mburoja metalike për mbrojtje nga shpatat, e unë me rrobat e shekullit XXI.

Dhe, nëse i përimitojë pamjet e atij momenti, më duket adekuate të them se më shikonin gjithë kureshtje, sikur luani që shikon iriçin ku ta kafshojë, por nuk gjend vend askund, meqë therrat e tij ia shpojnë gojën luanit.

MË URDHËRUAN TË HAPJA VARRIN E NJERIUT TË PANJOHUR!

Njeriun që e sollën para meje, Abusud Efendiu, ishte më i dituri i Perandorisë Osmane.

Ai më tha që do të mihja derisa të dilnin eshtrat e njeriut të panjohur, e që ishte varrosur aty 70 vjet më parë! Mihja ishte e rëndë. Dheu ishte rrasur shumë dhe therrat kishin lëshuar rrënjë. Dhe, pas shumë mundimesh arrita të eshtrat e burrit të panjohur, anonim. Eshtrat e tij ishin palosur në fund të varrit... Por, atyre nuk u interesonin eshtrat e tij - të drejtë a të shtrembër, por kishin pretendime se në atë varr fshihej një sasi ari... Mirëpo, kur Abusud Efendiu pa se veç eshtrave nuk kishte gjë tjetër, më pyeti: "A po të çon peshë vendi ku i ke këmbët?" Ula kokën ta shikoja dheun nën këmbët e mia dhe pash se dheu lëvizte... "Po", i them unë. "Je me këmbë në varrin e njeriut që është gjaku yt!", më tha dhe shtoi: "Duhet ta

kurseni tokën tuaj dhe ta ruani atë që ka mbetur!".

E, pas atyre fjalëve humbi nga sytë e mi... Në çast ngrita kokën, duke më mbetur fjalët ndër dhëmbë ta pyesja për shpjegime të mëtejme dhe cili ishte mesazhi i ëndrrës...

Dhe, për çudi, kadiu më i ditur i Perandorisë Osmane u rishfaq, nxori myhyrin nga xhepi dhe e vendosi në gishtin e unazës, që përdorej si vulë e dokumenteve pronësore...

Mirëpo, përplasja e fuqishme e llamarinave të fqinjëve ma nxori kllapinë e gjumit. Isha djersitur aq shumë, sa batanija me të cilën isha mbuluar ishte bërë qull. Në çast i dhashë dhe u ula në shtrat. Errësira t'i verbonte sytë, meqë rryma elektrike ishte ndalur nga era e fortë... Ndërkohë, dora e djathtë më shkon t'i prek këmbët, sepse më dukej se i kisha tërë baltë, që nga koha kur e hapja varrin e njeriut të panjohur...

Dhe, teksa i fërkoja këmbët e mia, gruaja rrotullohet në krahun tjetër. Por, as një minutë nuk kalon dhe kthehet kah unë.

"Çka drejtin nuk po rehatohesh?!", më thotë me zë të lartë.

"Pash një ëndërr të keqe! Më detyruan të hapja një varr! E, kur doli skeleti, toka nisi të dridhej nën këmbët e mia!", i thashë.

"A e di pse të është shfaqur ajo ëndërr?", më tha.

"Jo", i them unë.

"Mbrëmë folëm se Qeveria ia dha Manastirit të Deçanit 26 hektarë tokë të shqiptarëve", më thotë ajo.

Dhe, fill pas këtij muhabeti rrotullohem në krahun tjetër për të bërë edhe pak gjumë...

Safet Krivaça

TRAJTIMET ESTETIKE TË KOKËS DHE QAFES



Mbjellja e
Flokëve



Blepharoplasty



Facelift



Otoplasty



Rhinoplasty



Ngritje e
vetullave



Foxy Eyes



Chin
Liposuction



Chin Implant



Cheek Bones
Implant



Cantopexy



Lip Lift

Rr. Zef Jubani, Veternik - Prishtinë (Hyrja për në autostradë)

+383 (0) 45 707 744 | +383 (0) 43 707 744

Gjilanasia që mori pjesë në 30 luftëra!

Më 1997, kur ishte 11 vjeç, Vudi Xhemshitit, nga Gjilani, e që tash jeton në Londër, i erdhi në dorë një fotoaparati fotografik, "kamera e parë", teksa Kosova vuante nga regjimi i Slobodan Millosheviqit. Atëbotë nuk e dinte se ky veprim i thjeshtë do të ishte fillimi i një udhëtimi të gjatë, që do e çonte në frontet e disa prej konflikteve më të rënda të botës...

SI U BË VUDI XHEMSHITI REFUGJAT?

Është nga Gjilani, por jeton në Londër. Shtëpinë ia kishin djegur në luftë. Forcat militare dhe paramilitare serbe lëviznin shumë në rrugët e Gjilanit. Ata shpërndanin kartonë të verdhë për dëbimin e shqiptarëve të Kosovës.

Më pas ata kartonë shërbyen për të vrarë njerëz, e për të hapur varreza masive.

Kështu, si edhe shqiptarë të tjerë, ai u bë refugjat.

SI NISI KARRIERA E TIJ?

Para lufte, më 1997, është takuar për herë të parë me një fotograf gjerman. Ai ia falë një aparat fotografik. Dhe, me ngjarjet e luftës në Kosovë, iu përkushtua me të madhe fotografisë. Në cilësinë e fotoreporterit për herë të parë ka qenë në Rripin e Gazës, në vitin 2007. Aty ka punuar për gazetën e famshme "New York Times", si kohë prove.

Pastaj, ka marrë pjesë si fotoreporter lufte në pushtimet e Republikave Jugore të Osetisë, Abkasiçë Jugore në Gjeorgji.

Pas gushtit të vitit 2008, pat fatin që redaksi të ndryshme botërore ta kontaktonin, sidomos ato në SHBA. Dhe, në këtë vazhde të ngjarjeve, me aparat në dorë ka marrë pjesë në Armeni, Gjeorgji, Siri, Libi, Tunizi, Jemen, Egjipt, Somali, Mali, Bahrein, Gazë etj... Sidoqoftë, kudo ku ka marrë pjesë, në cilësinë e fotoreporterit të luftës,

jetën gjithmonë e ka pasur në rrezik, sidomos në vendet ku ka shkuar për herë të parë.

Konkretisht, jeta e tij ka qenë shumë e rrezikuar në Siri, meqë është rrëmbyer dy herë!

Në Ukrainë ka qëndruar tetë muaj. Edhe atje ishte vështirë, meqë ukrainasit nuk i besonin çdo kujt, pra duhej fituar besimin.

Në Ukrainë ka pasur rastin t'i dëgjojë dëshmitë trishtuese të tri grave, që ishin renditur për ekzekutim nga forcat e armatosura ruse, në rajonin e kryeqytetit Kiev.

Tregimet e tyre ishin të padëgjueshme më parë. Trimëria e tyre, përballë një dhune të pashembullt, ishte vërtet rrëqethëse...

Sidoqoftë, Vudi së shpejti do të niset për në Finlandë. Sepse, ka informacione se vendet baltike po ndërtojnë bunkerë në kufi me Rusinë dhe Bjellorusinë, sepse mund të ketë ofensiva ushtarake nga Rusia.

Andaj, historia e jetës së 37-vjeçarit, Vudi Xhemshitit, është histori e veçantë...

Sepse, kudo që merr pjesë në cilësinë e fotoreporterit të luftës, jetën gjithmonë e ka në rrezik.

Disa politikanë tanë flasin ndryshe, veprojnë krejt ndryshe!

Për të pasur ironia shkëlqim, goja duhet të flasë ndryshe nga ajo që është në zemër.

E kishin pyetur një dijetar se kush e ka zemrën më të mirë e më të bardhë? E, ai ishte përgjigjur: Zemër më të mirë se horri nuk ka kush!

Ndër ata që ndryshe flasin e ndryshe veprojnë, janë shumica e kryeministrave në botë.

Sepse, para se t'i niste trupat ushtarake në Ukrainë, Putini kundërshtonte dhe demantonte çdo deklaratë Perëndimore se i kishte grumbulluar mbi 200 mijë ush-

tarë për ta pushtuar shtetin fqinj, Ukrainën.

Ndërkaq, në anën tjetër, të gjitha pamjet satelitore dëshmonin gatishmërinë e sulmit!

Më në fund, para dy vjetësh, më 24 mars, Rusia hyri me trupa ushtarake për aneksimin e Ukrainës.

E, data, me siguri, ndërli dhej me fillimin e sulmeve ajrore të NATO-s mbi caqet ushtarake të Serbisë dhe të Malit të Zi, meqë të dyja bashkë e bënin Jugosllavinë e atëhershme.

GOJËMBËL, ZEMËRHELM!

Kur ndodhën demonstratat e viti 1981 në Kosovë, fqinji im, xha Bajrami, e që kishte qenë toger

ballisti, kur flisnin komunistët, thoshte: "Gojëmbël, zemërhelm!".

E, një gjë e tillë shihet edhe tash te disa politikanë tanë, të cilët flasin ndryshe e veprojnë ndryshe!

Sidoqoftë, është vështirë ta shohësh zemrën e tjetrit, ose çka ka brenda në zemër.

Sepse, kur e dëgjon flet bukur, mirë, ndërkaq vepron krejt ndryshe!

Kjo gjë më së miri ma përkujton kohën e fushatës elektorale, kur konkurrentët jepnin pafundësisht premtime...

E, votuesi i voton, ndërkaq politikanët premtimet nuk i realizojnë kurrë!

Mashtruese, a?!

S. Krivaça



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
AKADEMIJA NAUKA I UMETNOSTI KOSOVA
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

A ka Kosova Akademi të Shkencave dhe Arteve?

Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës është themeluar në vitin 1975, nga Kuvendi i atëhershëm i Kosovës. Ka 22 anëtarë të rregullt e 13 me korrespondencë. Shtrohet pyetja: Pse, krahas ngjarjeve shumë të rëndësishme në Kosovë, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës asnjëherë nuk del me vërejtje, propozime, sugjerime?!

Edhe pse Kosova tash është e pavarur, ka kohë që ballafaqohet me probleme e sfida të ndryshme.

Por, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës asnjëherë nuk është prononcuar për asnjë problem a sfidë nëpër të cilën po kalon Kosova që nga paslufta e deri më sot!

Akademia mund ta thoshte fjalën e saj rreth problemeve dhe debateve për kufirin me Maqedoninë e Veriut, kufi që njohu fshatrat e Kosovës në përbërje të Maqedonisë!

Edhe ngjarja me demarkimin e kufirit me Malin e Zi, për të cilin ishin organizuar disa tubime të profesorëve dhe politikanëve, që kishin shërbyer si zyrtarë në ish-Jugosllavi, Akademia nuk e tha asnjë fjalë!

Edhe për marrëveshjet e Brukslit për

dialogun Kosovë-Serbi, ASHAK do të duhej ta merrte rolin që do i takonte si institucion kulmor i dijes shkencore në Kosovë, meqë të gjitha problemet politike me Serbinë reflektojnë në terrenin e Kosovës.

As me statusin përfundimtar të Planit të Ahtisarit, Akademia nuk priu me ndonjë ide, propozim a sugjerim, e që do duhej ta bënte! Edhe ngjarjet që ndodhën dhe po ndodhin çdo ditë me kolonizimin e pjesës Veriore të Kosovës, për Akademinë e Shkencave dhe Arteve nuk paraqet kurrfarë problemi, sepse jemi dëshmitarë se asnjë reagim nuk ka pasur nga institucioni më i lartë shkencor i Kosovës!

Ndërkaq, individë jashtë Akademisë, konkretisht historiani Jusuf Buxhovi dhe profesori universitar Nysret Pllana, i pari me të dhëna historike e i

dyti me vrasjet dhe gjenocidin që ka ndodhur në Kosovë, u kanë plasuar botës se çka ka ndodhur para dhe pas lufte në Kosovë.

Por, mendoj se një pjesë të fajit në këtë vazhdë të ngjarjeve e kanë edhe te televizionet tona, e veçmas televizionet publike, që në tryeza dhe debate të ndryshme televizive kurrënjëherë s'na ka rënë të shohim ndonjë akademik në debate!

Shtrohet pyetja: Pse ndodhë kjo?

Injorohen akademikët apo?

Sidoqoftë, Akademia duhet të zgjohet nga gjumi. Sepse, për Kosovën nuk mjafton vetëm të botojnë libra shkencorë, por edhe ta ndihmojnë Kosovën me ide, propozime e sugjerime, në mënyrë që Kosova të ecë drejt përparimit të saj.

S. Krivaça



ALLURE BEAUTY JU KTHEN
20 VITE
pas në kohë!



Pa dhimbje! Pa kirurgji!
Allure Beauty

Përlësia, rruga e harruar drejt lumturisë

Kur dëgjoni fjalën përlësi, cili përku-fizim u bie ndërmend për këtë definicion? Çfarë ndjenjash zgjon kjo fjalë në botën tuaj emocionale?

A ekziston ende përlësia brenda shoqërisë sonë? Apo edhe me këtë virtyt, fatmirësisht të trashëguar, i kemi tejkaluar kufijtë e modernizimit nga përlësia në krenari dhe arrogancë të tepruar! Ndoshta edhe për shkak të kuriozitetit të tepërt, që posedojmë si popull i uritur për vlerat perëndimore, kemi harruar fuqinë e përlësisë, kemi harruar se ata që e bëjnë veten të vogël nuk humbin, por fitojnë në madhësi.

ME PËRLËSI NUK JEMI TË PAVLEFSHËM

Përlësia është një qëndrim dhe nuk konsiston në të qenit më i pavlefshëm apo më i parëndësishëm se të tjerët. Përlësia ka të bëjë më shumë me çlirimin e vetes (egos) nga supozimi i rëndësisë sonë. Përlësia, si virtyt, është një formë mirënjohje, urtësie, falënderimi dhe përkushtimi ndaj jetës dhe çdo nuance që buron nga e panjohura hyjnore, e që dërgon në më shumë ekuilibër, shëndet dhe shton momentet e lumturisë në jetën tonë.

Më kujtohet fjalia e Angela Merkelit, para se të merrte detyrën Kancelare, e kur tha: "Unë dua t'i shërbej Gjermanisë!". Dhe, a e dini se pse nuk e kam harruar? Sepse, e kam mbajtur mirë në mend fjalën shërbim! Por, te ne, njerëzit, sidomos te ne shqiptarët, që me shekuj jemi të përdhunuar për identitetin tonë, fjala shërbim në psikologjinë tonë zgjon në milisekonda ndjenjën e nënshtrimit. A do të thotë fjala përlësi të jesh i nënsh-truar apo përlësia është devotshmëri? Përlësi nënkupton të mos jesh kurrë mbi dikë, por edhe të mos jesh kurrë përfundi dikujt...

ME PËRLËSI NUK I NËNSHTROHEMI TJETRIT!

Fatkeqësisht, shumë nga ne besojmë se kushdo që tregon përlësi, e bën veten të

vogël dhe i nënshtrohet tjetrit. Thuhet se Aleksandri i Madh kishte urdhëruar që kur ta zgjonin nga gjumi, së pari, t'i rikujtonin se, para së gjithash, ishte njeri! Mos, ndoshta, Aleksandri i Madh mësoi që atëherë, nga mësuesi i tij, Aristoteli, se ai i cili përlësi nuk shkëlmohejt! Një keqkuptim filozofik për shekullin XXI, apo një virtyt i pluhurosur dhe i harruar që nga pacifisti më i zëshëm "Gandi i Ballkanit", Dr. Ibrahim Rugova (ndjesë pastë)! Përlësia, madje, edhe në psikologji ndër vite ka qenë një dilemë dhe konsiderohej si thikë me dy tehe dhe tani po rizbulohet nga psikologjia pozitive se është një aspekt i rëndësishëm për jetën tonë sociale, ku "zbutja" e egos, në pranimin e dobësive dhe kufizimeve tona si qenie njerëzore, e, para së gjithash, vetëdijesimi se nuk jemi të përherëshëm, promovon mirëqenien dhe fuqizon ndjenjën e përkatësisë ndaj njëri-tjetrit. Kur e pranojmë veten, përfshirë këtu edhe anët tona të errëta dhe të pa dashura, dhembshuria dhe ndjeshmëria rriten brenda nesh, atëherë neve nuk na duhet aq shumë energji për të ruajtur një imazh apo rol të caktuar. Edhe pse ne, njerëzit, jemi shumë të zënë me këtë "dhunti" të diskutueshme, unë dhe askush tjetër të mos harrojmë se nuk është mençuria, por është vetëm përlësia që të qon te urtësia!

Shkëndije Pacolli



PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges

Shkëndije Pacolli

Si më zuri taksirati me dy gra të Prishtinës?!

Të dielave, për çudi, më ndodhin gjëra të çuditshme, edhe përkundër faktit se jemi në muajin e Ramazanit, kur njerëzit flenë më shumë se zakonisht...

Disa pika shiu lagën asfaltin e lagjes ku ndodhet Redaksia, teksa e parkoj veturën në një hapësirë që nuk i pengon askujt. Një zonjë, bionde, rreth të pesëdhjetave, më afrohet afër dhe më pyet: "A ke me e lënë gjatë veturën në këtë vend që e parkove?" "Pse, u pengon?!", ia kthej unë. "Parkingu është për auto-shkollën e lagjes sonë!", më thotë ajo dhe vazhdon të flasë pa ndalur... "Kur e parkova veturën nuk pash të shkruante se për kë është i rezervuar parkingu, andaj edhe e parkova. E, nuk është hera e parë që e parkoj veturën këtu. Ka 12 vjet që veturën e parkoj

këtu dhe nuk ma ka tërhequr vërejtjen askush.

E ti, sot, hallakamë po e bën!", nuk u durova pa i thënë.

"E, tash, po të them se prej sot më nuk mund ta parkosh veturën këtu dhe hiq menjëherë!", thotë zonja.

Dhe, për të mos e zgjatur shumë, veturën e lashë aty ku e parkova dhe u nisa për në Redaksi, meqë jo larg është zyra nga parkingu.

E, teksa bëj hapa për në Redaksi, më shkon në mendje se bëra mirë që u largova prej saj, sepse po të vazhdonim me fjalorin që e nisëm, ndoshta edhe do më denoncoj për ngacmim seksual!

Sepse, pak me e kërcënuar ndonjë femër, ka ardhur koha që menjëherë të njollos, të denoncon me ngacmim seksual!

Por, kur arrij te dera e Redaksisë, shoh se ajo ishte vetëm pak hapa larg meje. Më kishte përcjellë se ku do ndalem, ku do hyj...

E, teksa e hapja derën, nga larg i dëgjova fjalët e saj: "Tash e thërras policinë dhe vijnë ta marrin veturën!"

Andaj, që të mos bija në nivelin e saj, heshta, nuk i thashë gjë...

Dhe, teksa hodha hapin të hyja në Redaksi, fqinji përballë, e që e kishte dëgjuar muha-

betin me zonjën, më thotë: "Haj-haj, janë çmendur gratë!"

TAKSIRATI ME ZONJËN TJETËR...

Me të përfunduar punën, nisem drejt veturës. Kur arrij te kontejneri i mbeturinave hedh qesen që e kisha në dorë.

Edhe këtu një zonjë më bërtet: "Pse po hedh mbeturina këtu?! A e di ti se kontejneri është vetëm për ndërtesën tonë?! Turp!"

"Kontejneri është për mbeturina, zonjë! Në kontejner nuk po shkruan që është i rezervuar për banesën tuaj!", i them.

"Shih ti, çka po dijshe me fol! Por, ta tërheq vërejtjen që më kurrë mos hedh mbeturina në kontejnerin tonë dhe ikë!", më thotë me nervozizëm.

Por, edhe mua m'u ngritën nervat dhe nuk u durova pa i thënë: "Zonjë, po t'ishe burrë do ishim marrë vesh lehtë, ndoshta edhe fizikisht! Por, meqë je femër, po të them se më nuk hedh mbeturina në kontejnerin tuaj! A jemi tash në rregull?!", i them sa për ta përmbyllur muhabetin.

Dhe, teksa largohem edhe prej saj, them me vete:

Sot, kjo e diel nuk qenka e mbarë! Qenkan ngritur në krah të majtë!

S. Murturi

Këndojnë më mirë nënat a bijat?

Shkurte Fejza, Shyhrete Behluli, Remzije Osmani, këngëtares tona të famshme, talentin e tyre në muzikë e kanë përcjellë edhe te bijat e tyre.

Gresa Behluli është e bija e Shkurte Fejzës, e cila e ka vazhduar rrugën e nënës në muzikë. Rrugën e nënës në muzikë e ka vazhduar edhe Ëngjëllusha Salihu, e bija e Shyhrete Behlulit. E, po rrugën e nënës në muzikë e ka ndjekur edhe Riola Hamzaj, e bija e këngëtares sonë Remzije Osmani. Shtrohet pyetja: Këndojnë më mirë nënat a bijat?



Shkurte Fejza dhe Gresa Behluli



Shyhrete Behluli dhe Ëngjëllusha Salihu



Remzije Osmani dhe Riola Hamzaj

BOOM

"Akademia Tesa"
dhe "Akademia Purebeau"
nga Gjermania sjellin
ngjarjen e madhe
për Permanent Makeup
dhe Estetikë

Cilët shqiptarë
kanë bukuri të veçantë?

Hoteli "Vanoro 5*"
në qendër të Selanikut
për pushim luksoz
që nuk do e harroni kurrë!



Hoteli "Vanoro 5*" në qendër të Selanikut për pushim luksoz që nuk do e harroni kurrë!



Selaniku është kthyer në një nga destinacionet më të vizituara për kosovarët. Ky vend i bukur ofron shumë për të parë. E, akomodimi është shumë i rëndësishëm për çdo turist...

Keni dëgjuar për Hotelin "Vanoro 5*", i cili ndodhet në qendër të qytetit të Selanikut?

I shpërblyer dy herë në "World Luxury Awards", Hoteli "Vanoro 5*" funksionon në një ndërtesë tërësisht të ruajtur nga viti 1937, në qendër të Selanikut.

"Hotel Vanoro Thessaloniki" hap dyert e tij, duke kombinuar dizajnin e menduar me atmosferën e qetë dhe shërbimin e shkëlqyer.

Duke kaluar pa probleme në një rishpikje moderne të një hapësire historike, dizajni i hotelit ofron një përvojë gjithëpërfshirëse larg zhurmave të qytetit, por çuditërisht afër karakterit të tij të lashtë dhe stilit të jetesës moderne e të rafinuar.

Pas rinovimit të përpiktë, u prezantojmë me një hotel urban me pesë yje në Selanik, që ofron dhoma e suita moderne dhe të gjitha lehtësitë përkatëse për turistët vendas, rajonalë dhe ndërkombëtarë, si dhe udhëtarët e biznesit.

AKOMODIMI LUKSOZ

Ky hotel, me 5 yje, ofron pajisje të nivelit të lartë dhe akomodime luksoze. Nga dhomat e bollshme deri tek dekori elegant, akomodimi juaj do të ketë një nivel të lartë komoditeti dhe stili.

Për më tepër, vëmendja e jashtëzakonshme ndaj detajeve në dizajnin tonë siguron një përvojë, vërtet, të pasur për mysafirët tanë.

E, shërbimi është i mrekullueshëm. Ekipi ofron shërbim të jashtëzakonshëm të përditshëm.

Nga mëngjesi a la carte gjatë gjithë ditës, te menyuja e kuzhinës dhe barit Anza, hoteli krenohet me një shumëllojshmëri opsionesh ngrënieje, duke përfshirë një restorant të mirë dhe një bar elegant.


Mysafirët mund të kënaqen me kuzhinën e shijshme mesdhetare, të përgatitur nga kuzhinierë të aftë dhe të shijojnë një përvojë të pasur ngrënieje. Në veçanti, ofertat e kuzhinës janë të kuruara për të ofruar një udhëtim gastronomik, që plotëson luksin e përgjithshëm të qëndrimit.

RELAKSOHUNI, RINOVUHUNI!

Relaksohuni, rinovohuni dhe përfitonini nga shërbimet e ndryshme të Wellness, të ofruara në Qendrën Spa dhe Fitness, duke përfshirë një Jacuzzi dhe Sauna! Për më tepër, objektet e Wellness janë të dizajnuara për të përmirësuar mirëqenien tuaj të përgjithshme, duke ofruar një ekuilibër të përsosur për kënaqësinë e akomodimeve luksoze dhe shërbimit të jashtëzakonshëm.

Një qëndrim në Hotelin "Vanoro 5*" në Selanik garanton një eksperiencë luksoze dhe të paharrueshme, me shërbim të jashtëzakonshëm, ngrënie gustator dhe lehtësira të nivelit të lartë.

Të gjithë elementët e mësipërm sigurojnë një qëndrim që shkon përtej pritshmërisë.



Po ashtu, shtojmë se Hoteli "Vanoro 5*" në Selanik shquhet si një destinacion unik për një eksperiencë mikpritjeje të pashoq.

Për më tepër, është e vetmja pronë 5* në Evropë që ofron mëngjes A la Carte gjatë gjithë ditës, nga ora 7.30 deri në orën 22.30 të mbrëmjes!

VENDNDODHJA NË QENDRËN HISTORIKE TË SELANIKUT

Hoteli "Vanoro 5*" ndodhet në vend ideal, në qendrën historike të qytetit të Selanikut, duke u ofruar mysafirëve një vendndodhje të mirë për t'u zhytur në kulturën dhe historinë e gjallë të qytetit. I pozicionuar në qendrën historike të qytetit, hoteli ndodhet në mesin e monumenteve të njohura, atraksionet dhe qendra pa zhurmë e qytetit.

Ç'THOTË PERSONELI I HOTELIT?

"Jemi, vërtet, një portë për pasurinë kulturore, kënaqësinë e kuzhinës dhe bukurinë piktoreske të Selanikut. Andaj, kushdo qoftë adhures i historisë, i ushqimit, apo dikush që kërkon relaksim, hoteli ynë ofron një strehë tërheqëse që rëmben thelbin e sharmit të Selanikut", thotë personeli i hotelit unik, që lënë mbresa të forta te çdo turist.



VANORO
HOTEL

www.vanorohotel.com

6th Dodekanisou Str. 54626,
Thessaloniki, Greece





“Akademia Tesa” dhe “Akademia Purebeau” nga Gjermania sjellin ngjarjen e madhe për Permanent Makeup dhe Estetikë

“Akademia Tesa”, e cila ka të drejtën ekskluzive për Kosovë dhe Shqipëri, në bashkëpunim me “AKADEMIA PUREBEAU” nga Gjermania, po organizojnë seminar për Makup permanent dhe estetikë.

Ky është një bashkëpunim i rëndësishëm për të sjellë njohuri të avancuara dhe praktika të fundit në fushën e estetikës dhe makeup-it permanent në rajonin e Shqipërisë e Kosovës. Titulli i seminarit është "Sekreti i suksesit".

Që nga titulli bëhet thirrje për të zbuluar strategjitë dhe praktikat, që mund të ndihmojnë në arritjen e suksesit në jetën personale dhe profesionale.

INOACIONET MË TË FUNDIT NË FUSHËN E BUKURISË

“Sekreti i suksesit” do të jetë një ngjarje e pazakontë, ku Kompania dhe Akademia Gjermane për Permanent Makeup dhe Estetikë do të ndajnë përvojën dhe inovacionet më të fundit në fushën e bukurisë. Në këtë eveniment të veçantë, do të zbulohen teknikat më

të fundit dhe praktikat më të freskëta që po transformojnë industrinë e bukurisë. Përse të merrni pjesë? Zbuloni inovacionet dhe teknikat më të reja në fushën e Permanent Makeup dhe Estetikës!

Merrni udhëzime dhe këshilla nga ekspertët e fushës për të përmirësuar aftësitë tuaja! Ndani përvojën dhe ndërveproni me profesionistët e njohur në



industrinë e bukurisë!

Dhe, nëse jeni pjesë e sektorit të bukurisë, ky eveniment është një mundësi e shkëlqyer për të përmirësuar praktikat tuaja dhe për të qëndruar në krye të inovacioneve në fushën e Permanent Make-up-it dhe Estetikës.

Rezervoni vendin tuaj sot për të mos humbur këtë ngjarje të rëndësishme!

Ç'THOTË EKSPERTJA KUJTESA GASHI-TESA?

Kujtesa Gashi-Tesa, nga "Tesa Academy", thotë: "Është nderë për të pasur Presidentin Dirk Hundertmark dhe trajneren ndërkombëtare Katarin Hundertmark nga Kompania dhe Akademia Purebeau Gjermane, me bazë në Gjermani dhe me përfaqësi në çdo shtet të botës, tani edhe në Shqipëri e Kosovë, si të ftuar të veçantë në seminarin tonë. Prania e tyre sjell një nivel të lartë ekspertize dhe përvojë në fushën e estetikës dhe makeup-it permanent, duke e bërë këtë seminar një mundësi e jashtëzakonshme për të mësuar nga liderët në industri".

Kujtojmë se "Academia Purebeau" dhe Kompania "Purebeau" hapin dyert për trajnerët ndërkombëtarë në Kosovë e Shqipëri.

Tesa shton më tej:

"Është një kënaqësi të njoftojmë se Akademia Purebeau dhe Kompania Purebeau kanë arritur në Kosovë dhe Shqipëri për të ndarë përvojën e tyre në fushën e bukurisë në nivel ndërkombëtar. Si një hap i madh drejt inovacionit dhe përparimit, ne jemi të lumtur të bëjmë të ditur se hapim dyert për trajnerët e talentuar ndërkombëtarë për të bashkuar forcat me ne në këtë udhëtim të bukurisë së përjetshme".

Suksese!

Nderim Neziri



Cilët shqiptarë kanë bukuri të veçantë?

Te ne, shqiptarët, nuk ka vetëm femra të bukura, por edhe meshkuj, e që falë pamjes së tyre kanë arritur të kenë një plasim edhe më të mirë, të jenë në sytë e qindra femrave që i adhurojnë për fytyrën, fizikun, karakterin...



BLERIM DESTANI

Të paktë janë ata që nuk e njohin Blerim Destanin. Ama, më së miri e njohin femrat që e adhurojnë për pamjen dhe stilin tipik mashkullor.

Është aktor me renome dhe kushedi se sa vajza e ëndërrojnë çdo natë...



NIK XHELILAJ

Është vlerësuar me çmimin "Aktori më i mirë" në festivalin e Moskës, në festivalin e Prishtinës, në festivalin e Antalias dhe në atë turko-gjerman të Nurembergut, për rolin në filmin "Shqiptari - Der Albaner". Nik Xhelilaj spikat për talentin, por edhe për tiparet e një mashkulli të bukur.

S'ka dyshim që ai thyen shumë zemra femrash...

LORIK CANA

E ka të gërshetuar mrekullueshëm njerëzinë, talentin dhe pamjen e jashtme.

Lorik Cana ishte në qendër të shigjetës nga shumë femra ndër vite, por ai tashmë është i martuar dhe të tjerat vetëm mund ta shohin në ekranin televiziv...



LEDRI VULA

Historia e tij e bujshme me këngëtaren Dafina Zeqiri, lidhja e shkurtër me modelen seksi Angjela Martini, martesë me Sara Hoxhën, e bëjnë atë një mashkull që ka vjedhur shumë zemra femrash seksi dhe të njohura...



Përzgjedhja e një apartamenti, ofron hapësirë, komoditet dhe privatësi absolute.

Zgjedhja ideale
The_wish_house

Fetoje kohën tënde!

 /the_wish_house

A ka bërë operacion plastik Artiola Toska?



Ka zë të mrekullueshëm dhe ëmbëlsi të pakrahasueshme. Jo më kot mbetet e dashur prej shumë e shumë vitesh. E, ndonëse vitet ikin, Artiola mbetet gjithherë e freskët. Ndoshta është nga të paktat

artiste që nuk ka bërë ndërhyrje të kirurgjisë plastike. "Sa i përket operacioneve plastike apo ndërhyrjeve të lehta, në Shqipëri po aplikohen shumë. Nuk jam dakord, sidomos, me ato femra që i bëjnë

të tilla gjëra në moshë të re, ndërkohë që kanë vetë freskinë e moshës. Megjithatë, gjithçka varet nga dëshira e secilit, por unë nuk do të bëja kurrë një gjë të tillë", ka thënë shumë herë.



A më shumë provokojnë djemtë a vajzat?

"S'kam probleme me djem, por me vajza që i provokojnë meshkujt!", thotë një mësuese nga Lipjani.

Një mësuese me përvojë 40 vjeçare në një shkollë të Lipjanit, tregon se është më shumë në zor me vajza sesa me djem në shkollën ku ajo punon. Sepse, siç thotë ajo, probleme nuk bëjnë djemtë, por vajzat.

Pse? Përgjigjja është e thjeshtë: Vajzat në shkollë dhe kudo në vende të tjera vishen me veshje provokuese, e që ekspozojnë pjesë lakuriqësie! Shtrohet pyetja: A s'është ky provokim, a?!

Early
bird



+355 69 604 1000 | marinabay.al

Akademiken familja donin ta martonin me zor!

Ajo vinte drejt meje me fytyrë të zbehtë. Kishte qëndruar tërë natën pa gjumë. I ishte mbushur mendja se ishte bërë e tepërt në shtëpinë e saj, tek jetonte kohëve të fundit.

Të jetojë secili vetëm po konsiderohet si kohë moderne. Demek, kohë ku secili anëtar i familjes e ka vendin e vet sociologjik, në kuadër të drejtësisë së barabartë familjare.

E kanë bindur në shtëpi se është bërë e tepërt, aty ku është lindur, rritur e shkolluar.

“Është bërë boll në shtëpi! Më duhet të ik dikah, ta gjej fatin!”, më thotë ajo.

KISHTE MË SHUMË “PSE” SE STERIO SPASSE!

Në pamje duket sikur ecë duke i bërë vetes 1001 pyetje, e që fillojnë nga pyetjet enigmatike me pse... Pse u linda?

Pse u rrita?

Pse jetoj?

Pse punoj?

Dhe, shumë psee, si të Spasses së madh. Shoh një lum lotësh brenda saj.

Por, ajo s'ka guxim të qajë në rrugë.

E ka maskuar fytyrën, por unë shoh se te ajo, si te oda e gërmadhës, nga brenda del çdo gjë.

Flet pamja, flet depresioni...

Sa shumë mund ta gjej veten njeriu, them me vete. Sheh një vajzë të bukur dhe mendon se çdo gjë brenda saj është po aq e bukur, sikur duket nga jashtë.

Mund të preket, madje, edhe nga ngacmimet e rrethit të saj, që e marrin për një bukuroshe të ndërtuar e të mbushur lumturi!

Në fakt, nuk e dinë se brenda saj jeton një femër krejt tjetër, e cila, realisht, mendon se shtëpia duhet t'u mbetet të tjerëve dhe se ajo, vërtet, duhet ta braktisë shtëpinë me çdo kusht, sepse aty më nuk e ka vendin dhe se është bërë e tepërt.



DEL NGA SHTËPIA SI BLETA KUR LËSHON!

Dhe, e gjeti apo nuk e gjeti fatin, ajo duhet të del si bleta kur lëshon...

Më mbetet në kokë pamja e saj, tek ndajë bindjen se si mund të ketë, në shekullin XXI, ende sjellje të tillë ndaj fëmijës.

Më mbetet në kokë pamja e saj me lotët e brendshëm, tek e ka bindur veten se shtëpia e saj më nuk është e saj!

Nuk është i saj as oborri, të cilin e ka pas-truar me mijëra herë!

Nuk është e saj as dhoma e vet, as shtrati ku fle!

Pra, nuk janë të saj shkakut i një burri që do ta ketë, deshi apo jo.

Sepse, nëse s'do e gjejë vetë, do ia gjejnë familja me çdo kusht, edhe pse ajo është akademike.

B. Bajrami



Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco
vaten



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë

+383 45 224 540

Prizren

+383 43 900 902

Gjilan

+383 45 505 043

Gjakovë

+383 44 545 444



Dashnori i parë u kalltë n'xhehnam!

Hera e parë nuk harrohet, sepse është përvojë e diçkaje të panjohur që e kemi bërë.

Sidoqoftë, shumë herë dashuritë që vijjnë më vonë janë më të fuqishme dhe lënë mbresa e kujtime më shumë se ajo e para...

Është e vërtetë se hera e parë kujtohet për ndjenjat e para të forta, për frikën, për eksperiencën e parë...

Por, në qoftë se një dashuri tjetër më e vonshme është edhe më e fortë, më e fuqishme dhe më e bukur, gjithçka harrohet.

Por, s'ke pse e kujton dashurinë e parë kur në krahë ke dikë, të cilit i dedikohesh tërësisht dhe e do e të do me

gjithë shpirt...

Andaj, me kalimin e kohës, edhe dashuria e parë, e paharrueshmja, siç thuhet, harrohet, madje as që të kujtohet!

Por, a mendojnë kështu edhe të anketuarit tanë?

**NDERIMI, 41 VJEÇ, GJAKOVË:
SA MË SHUMË
QË DASHURON,
AQ MË SHUMË E KUPTON
SE Ç'ËSHTË DASHURIA!**

- Mendoj se gjithsecili ka një farë nostalgjie për dashurinë e parë, por nuk do të thotë se dashuria e parë edhe nuk mund të harrohet.

Sidoqoftë, një fjalë e urtë thotë se sa më tepër të dashurosh, aq më tepër e kupton se ç'është dashuria!

E, sa i përket dashurisë së parë, jam dashuruar që në vitin e tretë në gjimnaz, në një shoqe të klasës sime.

Jemi dashuruar, por nuk e ka ditur askush, sepse tinëz jemi dashur, tinëz jemi takuar, tinëz jemi puthur, tinëz jemi ndarë!

Por, edhe pse tash po e zë n'gojë, nuk do të thotë se ende e dua...
Ishte, ka qenë, ka shkuar!

**SIHANA, 31 VJEÇE, FERIZAJ:
I DASHURI I PARË
ISHTE I PAFYTYRË!**

- Dashuria e parë ma kujton vetëm vuajtjen!

E kam dashur, i kam besuar, por ai ishte i pandërgjegjshëm, i pafytyrë. As që e kam ditur se ai ishte i martuar, sepse në pamje dukej i ri e me sjellje si i papërvojë!

Ai, me dinakërinë më të madhe, duke shfrytëzuar sinqeritetin tim, papërvojën time, më shfrytëzoi dhe më la!

E, kur e kujtoj, e bëj vetëm për ta mallkuar dhe me shpirt e urrej!

Pra, dashuria ime e parë, ishte fatkeqel!

PËR FUND

Nga rrëfimet e dy të anketuarve tanë shihet se dashuria e parë më shumë kujtohet për papërvojë, për dhembje, për vuajtje...

E, ç'mendim keni ju?

Diturie Haxhaj



Burri mu ka bërë dreq!

Jam 31-vjeçare, e martuar qe dy vjet.

Kemi kaluar me burrin dy vjet para se të fejojeshim...

Ai ende më do dhe nuk ka hequr dorë për asnjë sekondë prej meje, duke më dashur si nga dita e parë, për çka më bën më së shumti obliguese ta dua edhe unë.

Por, në mua gjërat kanë ndryshuar!

Tri herë jam larguar prej tij. Jam ndarë me iniciativën time...

E, duke m'u lutur që të jetojmë bashkë, i jam kthyer...

Sidoqoftë, pas çdo kthimi, më ka ardhur si me vrull një ide se unë aty nuk kam jetë...

Herën e tretë kur jam kthyer, burri më ka thënë se po shkova edhe një herë, s'ka më kthim mbrapa!

Çka të bëj, sepse shpeshherë po më vjen një turr që s'po mund ta shoh burrin me sy, m'u ka bërë dreq?!

Lenorja, Deçan

Tri herë je ndarë nga burri, sepse të tri herët ke ëndërruar se do të shkosh te ish-i dashuri në Gjermani, i cili, edhe kur je njohur me të, të ka thënë se do të marrë me vete në Perëndim.

Por, nuk ka arritur të ta sigurojë vizën, meqë edhe vetë ende nuk e ka të rregulluar statusin e qëndrimit atje.


Dhe, ti, duke shpresuar se ai do të të marrë në Gjermani, je konfliktuar me burrë, në mënyrë që ai të të përzë, e ty të të hapet rruga për në Perëndim. Të këshillojmë të mos jetosh me ëndrra, por bëhu pjesë e jetës reale dhe përkushtoj burrit, ashtu si ai është i përkushtuar ndaj teje, pa hile!

Redaksia

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play



Martohu me femër të huaj dhe ikë nga Kosova!

Martesa në vendin tonë konsiderohet si themel i familjes. Njerëzit hyjnë në martesë për disa arsye: krijimi i familjes, qëndrueshmëria ekonomike, edukimi dhe kujdesi për fëmijët etj.

Por, nëse kthehemi në kohë, shohim se martesa, si institucion, ka ndryshuar edhe në Kosovë, si rezultat i faktorëve të ndryshëm, duke kaluar nga martesa "tradicionale" në "martesë moderne".

E, një prej faktorëve që kontribuon në këto ndryshime është edhe martesat

e qytetarëve kosovarë me shtetas/e të huaj/a.

Ç'SHIFRA JAPIN STATISTIKAT?

Statistikat për martesat e kosovarëve që jetojnë në Perëndim, tregojnë se numri i martesave të qytetarëve kosovarë me shtetas/e të huaj/a gjatë vitit 2023 ka qenë 2.856.

Prej tyre, numri më i lartë ka qenë i burrave, të cilët janë martuar me gra jo shqiptare, pra gjithsej 1.515, krahasuar me vajzat, të cilat janë martuar me burra jo shqiptarë, në total 1.350. Numri më i madh i martesave të qytetarëve të Kosovës me shtetas të huaj ka qenë në vitin 2022, me gjithsej 3.564 kurorëzime.

Ç'THONË SOCIOLOGËT?

Me kurorëzimin e kosovarëve me të huaj, mundësia e largimit nga vendi është më i madh.

E, kjo bënë që familja tradicionale kosovare të pësojë ndryshim në strukturën e saj.

Në këtë temë, sociologët thonë se sa i përket aspektit ekonomik, remitencat mund ta lehtësojnë jetesën ekonomike për pjesën tjetër të familjes të cilët jetojnë në Kosovë.

Por, aspekti emocional është tejet i rëndësishëm, meqë prindërit përjetojnë ndjenja të vetmisë dhe ndarjes nga fëmijët e tyre.

Sidoqoftë, martesa është e garantuar edhe me Deklaratën për Drejtat e Njeriut...

A family of six, including a man, a woman, two children, and an older man, are walking together in a lush garden area. They are holding hands and looking towards the camera. In the background, a tall, modern apartment building with a grid-like facade and illuminated windows stands against a twilight sky. The scene is filled with greenery and colorful flowers, creating a warm and inviting atmosphere.

**Pranvera stina më e bukur
për fillimet e reja!**

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Në hall me nusen

Jam një nënë nga Gjilani, jetojmë me djalin dhe nusen e tij. Halli ynë është se nusja nuk na pyet për asgjë: del kur të dojë nga shtëpia, kthehet kur të dojë vetë...

Duket se më as vëllai nuk ka dorë te ajo, e as ndikim! Ne ia kemi tërhequr disa herë vërejtjen, por ajo e bënë të veten.

Po brengosemi se çka do t'i ndodhë vëllait me të, sepse i dëgjojmë natën kah përлахen me fjalë?!

Çka na këshillon, zonjë e nderuar?

"Pa shifër"

Përgjigje:

Para së gjithash, mirë që ende nuk kanë fëmijë, sepse do të linin vuajtje dhe pasoja...

"Derisa nuk kanë fëmijë, zgjidhja më e mirë është të ndahen dhe të mos jetojnë me zor bashkë", siç thuhet në popull. Më së miri është ta lirojnë njëri-tjetrin dhe çdo gjë të mbarojë mes tyre...

Këshilla ime është që ata vetë

t'i zgjidhin problemet e tyre, pa ndërhyrjen tuaj!

A ka burri ndjenja për mua?

Përshëndetje magjistare e nderuar, jam një zonjë, jetoj jashtë vendit.

Kam bërë një gabim, sepse, si duket, më kanë lindur ndjenjat në mënyrë të pakontrolluar me një person me të cilin punojmë bashkë.

Unë kam qenë besnike ndaj burrit, por afërsia e bëri të veten dhe tash, kur unë e dua, ai po ikë prej meje! A ka ndjenja ndaj meje, apo është harxhuar?

"Jeta 1"

Përgjigje:

Çdo lidhje në të zezën është me ndjenja dhe nëse ato nuk do të ekzistonin, ju nuk do të ishit tradhtuar!

Megjithatë, ai ka bërë zgjidhjen më të mirë, duke u distancuar, sepse e ka kuptuar se po thellohet lidhja dhe në të dy anët mund të shfaqen pasojat, prandaj edhe për ty është shumë më mirë ta frenosh veten dhe t'i kthehesh jetës

familjare...

Unë shoh se ai person nuk ka më ndjenja për ty sikur që i kishte në fillim të lidhjes suaj...

Ku ta kërkoj fatin pas ndarjes?

Zonjë, jam 28-vjeçare, jetoj për momentin në Gjermani. Jam ndarë nga burri.

Unë, realisht, e kam dashur dikë tjetër deri tre muaj pas martesës, kur edhe kam filluar ta dua burrin tim.

Edhe ai më ka dashur mua aq shumë sa nuk kemi parë dikë tjetër jashtë njëri-tjetrit. Por, një ditë u zbuluan lidhjet e mia me të parin që e kisha, edhe pse ky nuk është që nuk e ka ditur.

U grindëm shumë, u ndamë. Dëgjoj nga rrethi familjar se ai po vuan...

Familjet tona e kanë lënë vendimin në duart tona dhe më e mira është se nuk kemi probleme me familjet tona. A po vuan ai për mua dhe ku e kam fatin?

"Dashuria"

Përgjigje:

Ajo që del te unë sigurt: Ju jeni akoma të mllefosur në njëri-tjetrin.

Ai e ka ditur se ti e ke pasur atë person si ofertë me të cilin keni folur, por nuk e ka ditur se ti ke qenë me të në lidhje dhe se i keni pasur të gjitha së bashku. Kjo e ka shokuar ish-burrin tënd, i cili do të bëjë një martesë në verën që do vjen, por nuk do të jetë i lumtur me të, meqë zemra i ka mbetur te ti,

pa marrë parasysh se çka ka ndodhur ndërmjet jush. Dhe, meqë nuk do të rehatohet me të, do të rikthehet te ti përsëri...

Letër prekëse e një nëne

Përsëritje, jam nënë, 47-vjeçare, vuaj nga një sëmundje e rëndë. Kam një djalë të vetëm që na e fali Zoti vonë. Pas lindjes së tij, burri im vdiq aksidentalisht dhe më la të përballim me djalin, e që tashmë është rritur... Jam e sëmurë, por më shumë jam e plagosur për tim bir si do të jetoj pa mua, si do të arrijë ta sigurojë kafshatën e gojës?

“Nëna e përbotur”

Përgjigje:

Para së gjithash, Allahu xh. h. ka jetë për të gjithë. Ka edhe ilaçe për të gjithë, ashtu sikur mund të ketë edhe për ty. Ka bukë edhe për djalin tënd, e për fëmijët tjerë. Por, më e rëndësishmja është të shërohesh ti dhe të jetosh bashkë me të birin dhe ta shohësh të martuar e me fëmijë. Mos e paragjyko më të keqen! Jetoje jetën me dinjitet dhe kujtoje se në botë ka drama shumë të tmerrshme njerëzore, që u ndodhin njerëzve... E, sa i përket sigurisë jetësore, askush nuk është i sigurt, nuk ka garanci se do jetojmë deri nesër.

A ndikon koha në disponimin personal?

Jam një zonjë nga Prishtina, 56-vjeçare, dua të di nëse ndikon koha në disponim personal të njeriut... Në një emision në radio dëgjova se koha ndikon shumë në disponimin e njeriut. A është kjo e vërtetë?

“E. Sh.”

Përgjigje:

Interpretimet religjioze se si kohët e ndryshme ndikojnë në disponimet e njerëzve, qëndrojnë dhe janë mjaft të sakta. Një kohë me shi dhe vrëntë prek psikën e 60% të njerëzve, të cilët gjatë asaj kohe ndryshojnë vrotimet për jetën, duke degraduar nga disponimi gjatë gjithë asaj kohe sa zgjasin vranësirat. E, një ditë e bukur dhe me diell, qysh në mëngjes sinjalizon trurin se ai po ushqehet me ngritje disponimi dhe humori të lehtë. Konkretisht, në pyetjen tuaj, përgjigja reale: koha ndikon në disponim personal.

Kush po i shkruan burrit tim në telefon?

Sot, ditë e diel, u zgjova nga gjumi e gëzuar për ta vazhduar një ditë tjetër të jetës. Por, fjalët që ia gjeta burrit tim në telefonin e tij më shokuan dhe ma ndryshuan jetën! Andaj, nuk di si do të jetoj pas asaj që lexova në telefonin e burrit... Me burrë jetojmë jashtë Kosovës dhe, të paktën, jetoja e gëzuar se nuk kisha prob-

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

leme me burrë. Më jep një këshillë, sepse jam në siklet të madh dhe pa asnjë zgjidhje?

“Nga larg”

Përgjigje:

Para së gjithash, duhet të keni një zemër të madhe, që të jeni e gatshme të falni. Jeni në një shtet me civilizim dinamik në jetë dhe askush nuk është i amnistuar nga ndodhitë e lidhjeve intime apo të dashurive të lejuara e të palejuara. Mesazhin në telefonin e burrit tuaj merreni si një test sprove, ku ju e keni testuar vetveten sa jeni xhelozë apo sa e dini rëndësinë e bashkëshortësisë... Por, realisht, jeta juaj dhe lidhja juaj mund të perfeksionohet edhe pas këtij shokimi që keni përjetuar me t’u zgjuar nga gjumi. Normalisht, ka reperkusione emocionale në lidhjen tuaj bashkëshortore dhe kjo do të zgjat një kohë, derisa ta riktheni vetëbesimin... E, në anën tjetër, analizo pse ai ka gjetur një tjetër: A thua, je ti ajo që nuk e ke pajisur me të gjitha që i duhen burrit, apo ai ka bërë një aventurë të rrezikshme?! Sidoqoftë, ofroje burrin, sepse nëse ti nuk e ofron ai do të largohet edhe më shumë!

Cilët janë më demelët e Horoskopit?

Disa njerëz janë “të etur” për qëllimet e tyre, për jetën e tyre të ëndrrave dhe janë të gatshëm të bëjnë gjithçka për ta pasur, por, nga ana tjetër, ka edhe nga ata që rrinë vetëm shtrirë dhe s’bëjnë asgjë për veten.

Sipas astrologëve, një pjesë të fajit e ka edhe Horoskopi, ndaj u njohim me 3 shenjat më dembele...

LUANI

Të gjithë janë të vetëdijshëm për aftësitë dhe pasionin që ka Luani, kur bëhet fjalë për të bërë gjëra të mëdha.

E vetmja dobësi që kanë është dembelizmi. Ata duan të jenë më të mirët dhe vetëm më të mirët! Por, janë shumë dembelë për të punuar për këtë...

SHIGJETARI

Shigjetarët nuk duan të jenë “të

ngecur” në rutinë. Ata kanë frikë nga ideja për të punuar me orarin 8 orë në ditë dhe shpesh nuk janë të përkushtuar kur bëhet fjalë për të punuar shumë për të arritur diçka.

UJORI

Ujorët janë njerëz argëtues dhe optimistë.

Është ky optimizëm që i detyron ata të mendojnë se do t’i arrijnë ëndrrat e tyre, thjesht, duke u ulur gjithë ditën në divan dhe duke menduar për to.

Ata janë njerëz dembelë, por nuk e pëlqejnë monotoninë e punës...



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE